**V E N D I M**
**Nr.51, datë 30.1.1995**

**PËR DISA NDRYSHIME E PËRMIRËSIME TË AKTEVE TË PROCESIT TË PRIVATIZIMIT**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të privatizohen, sipas dispozitave në fuqi, nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit vetëm ato ndërmarrje që janë publikuar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Të gjitha ndërmarrjet që janë paraqitur për t'u privatizuar dhe ndodhen në faza të ndryshme të procedurës së privatizimit dhe që nuk janë publikuar, do të privatizohen sipas dispozitave të reja që do të përgatiten.

3. Të pezullohet ulja e vlerës aktuale të mbetur për ndërmarrjet e publikuara për privatizim.

4. Të ruhet vijimësia e procesit të privatizimit, duke përgatitur deri në datën 27.2.1995 vendimin e ri të Këshillit të Ministrave për këtë qëllim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
**Aleksandër Meksi**